

VENDIM
Nr. 45, datë 27.11.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 30, DATË 29.5.2015, TË KOMITETIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE, SI DHE PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR
PROJEKTET NË VAZHDIM, ME CIKËL FINANCIMI
2012–2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 30, datë 29.5.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2015”, bëhen ndryshime, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese me projekte të financuara sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të paraqesin, rregullisht, pranë Sekretariatit Teknik, në Ministrinë e Kulturës, informacion për ecurinë financiare të disbursimeve të projekteve, të shoqëruar me dokumentet përkatëse.

3. Ngarkohet Sekretariati Teknik, pranë Ministrisë së Kulturës, të kryejë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, sipas dokumenteve të paraqitura nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi.

4. Shpërndarjen e fondeve për projekte në vazhdim, me cikël financimi 2012–2013, për programin art-kulturë, sipas tabelës 2, bashkë-lidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Kulturës, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;

Tabela 1. Lista e projekteve të programit Art - Kulturë, me reduktim financimi për 2015, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e bashkëfinancimit	Vlera e financimit të miratuar për vitin 2015 (në lekë)	Fondi që i reduktohet financimit në vitin 2015 (në lekë)
QARKU KORÇË						
1	Bashkia Korçë	Rikonstruksioni i Teatrit "A.Z. Cajupi"	119,974,660	59,987,330	15,106,000	8,106,000
QARKU SHKODËR						
2	Bashkia Shkodër	Rikonstruksioni Godinës së Teatrit "Migjeni"	85,637,068		17,000,000	5,000,000
TOTALI			205,611,728	59,987,330	32,106,000	13,106,000

Shënim:

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoriteti kontraktues). Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Kulturës).
2. "Vlera e bashkëfinancimit" përfaqëson angazhimin financiar të Ministrisë së Kulturës, si marrëveshje bashkëfinancimi për këtë projekt. Pjesa e mbetur e financimit është angazhim i Bashkisë Korçë, në vlerën 59,987,330 Lekë. Vlera e financimit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Kulturës).
3. "Vlera e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e financimit që u vu në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, që miratuan financimin e objektit.
4. "Fonde që i reduktohen financimit" për vitin 2015, tregon vlerën e fondit të reduktuar, nga financimi për për vitin 2015, për objektet që kanë ecuri punimesh nën vlerën e financimit të miratuar në vendimet e mëparshme të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2015. Kjo vlerë do të planifikohet për financim në vitin 2016.

Tabela 2. Projektet në vazhdim, programi art-kulturë, me cikël financimi 2012-2013

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (në lekë)	Vlera e mbetur për financim (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në Lekë)
QARKU VLORE							
1	Bashkia Sarandë	Varrezat monumentale të shqiptareve të çamërisë në Killoqer, Markat	77,000,000	46,946,128	30,053,872	10,000,000	20,053,872
TOTALI			77,000,000	46,946,128	30,053,872	10,000,000	20,053,872

Shënim:

1. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Kulturës).
2. "Vlera e financimit" për vitin 2014 tregon vlerën e financimit që u vu në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, që miratuan financimin e objektit.
3. "Vlera e mbetur për financim", tregon vlerën e detyrimit financiar, mbas diferencës së vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit për vitin 2014.
4. "Vlera e financimit", për vitin 2015, tregon vlerën e financimit që u vihat në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015.
5. "Vlera e financimit", për vitin 2016, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së mbetur për financim dhe vlerës së financimit për vitin 2015.

